



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

**PLANI KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E  
MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT**

**2007**

**ANGAZHIMET E SHËNDETËSISË**

**TIRANE, KORRIK 2007**

## **AFTESIA PËR TE PERBALLUAR DETYRIMET E ANTARSISE NE BE**

### **LEVIZJA E LIRE E MALLRAVE**

#### **PAJISJET MJEKËSORE**

##### **1 Objektivi politik**

Sigurimi në mënyrë graduale i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet dhe rregullat teknike mbi sigurinë e produkteve shqiptare dhe procedurat evropiane të vlerësimit të konformitetit, është një nga detyrimet kryesore të vendit tone, i cili përcaktohet në nenin 75 të MSA-së.

Rritjen e sigurimit të kapaciteteve administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe të arrijë një progres të dukshëm në transpozimin e direktivave të përafritit të ri, global dhe të vjetër. Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kujdesit shëndetësor për popullatën nëpërmjet reformimit të thellë të sistemit shëndetësor aktual bazuar në modelet dhe përvojat me të suksesshme bashkëkohore.

##### **2 Situata aktuale**

###### **2.1 Kuadri ligjor ekzistues**

Ligjet dhe aktet e tjera që nuk transpozojnë akte komunitare

Fusha e pajisjeve mjekësore rregullohet nga legjislacioni i mëposhtëm:

- Ligji nr. 9097, datë 3.7.2003 " Për vlerësimin e konformitetit " i cili është bazuar në Traktatin që themelon Komunitetin Evropian, Titulli I "Lëvizja e Lirë e Mallrave", nenet 23-31, neni 100.
- VKM nr. 723, datë 05.11.2004 "Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmave të autorizuara për kryerjen e vlerësimit të konformitetit"..

###### **2.2 Kuadri institucional ekzistues**

- a) Ministria e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë në lidhje me pajisjet mjekësore. Ajo funksionon në bazë të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave". Aktualisht në Ministrinë e Shëndetësisë funksionojnë këto organe përgjegjëse për kontrollin e pajisjeve mjekësore:
- b) Drejtoria Spitalore dhe Sektori i Stomatologjisë- liçenson importimin e pajisjeve mjekësore;
- c) Komisioni i Liçensimit-liçenson aktivitetet për importimin dhe tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore;
- d) Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet-kontrollon burimet e radiacionit jonizues;
- e) Njësia për Standardizim dhe Menaxhim e Pajisjeve Mjekësore në Ministrinë e Shëndetësisë

##### **3 Adresimi i prioriteteve**

###### **3.1 Prioritetet afatshkurtra (2007 -2008)**

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

- *Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;*

- *Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafritit të ri*

### 3.1.1 Inicativat ligjore afatshkurtra (2007 – 2008)

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Projekt-ligji "Për pajisjet mjekësore", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 90/385/EEC "Për përafritimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me pajisjet mjekësore të implantimit aktiv"; Direktivën 93/42/EC "Mbi pajisjet mjekësore" dhe Direktivën 98/79/EC "Mbi pajisjet mjekësore të diagnostikimit "in vitro";
- Projekt-VKM "Për zbatimin e ligjit për pajisjet mjekësore".

### 3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra (2007 -2008)

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Ngritja brenda strukturës së Ministrisë së Shëndetësisë e Autoritetit Kompetent për pajisjet mjekësore dhe ngritja e Agjencisë Shtetërore të Pajisjeve Mjekësore si domosdoshmëri e zbatimit të kërkesave të legjislacionit përkatës.
- Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve të Autoriteteve Kompetente
- Ngritja dhe fuqizimi i Njësisë së Inxhinierisë Klinike në nivel spitali.
- Hartimi i një plani veprimi për parashikimin e aktiviteteve dhe masave në kuadrin e ligjit

## 3.2 Prioritetet afatmesme (2009-2010)

- *Ngritja dhe fuqizimi i vazhdueshëm i kapaciteteve teknike për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;*
- *Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafritit të ri*

### 3.2.1 Inicativat ligjore afatmesme (2009-2010)

- Projekt-akte për zbatim të ligjit për pajisjet mjekësore

### 3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme (2009-2010)

- Ngritja në sistem e edukimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të Autoriteteve Kompetente dhe të Njësisë të Inxhinierisë Klinike në nivel spitali për plotësim kuadri ligjor, menaxhim dhe standardizim të pajisjeve mjekësore.

## 3.3 Prioritetet afatgjata (2011-2012)

- *Përafritim i plotë me aktet e komunitetit evropian dhe zbatim i tyre në praktikën me pajisjet mjekësore.*

**Tabela 1**

**Forcimi i kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Shëndetësisë**

INVESTIME	NJËSIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	VITET			
			2007	2008	2009	2010
1.Shtim personash	persona	5	2	4		
.Trajnime (mijë lekë)	(mijë lekë)	1250	1250	7500	5625	7500

# BARNAT PËR PËRDORIM NJERËZOR

## 1 Objektivi politik

Sigurimi në mënyrë graduale i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet dhe rregullat teknike mbi sigurinë e produkteve shqiptare dhe procedurat evropiane të vlerësimit të konformitetit, është një nga detyrimet kryesore të vendit tone, i cili përcaktohet në nenin 75 të MSA-së. Rritjen e sigurimit të kapaciteteve administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe të arrijë një progres të dukshëm në transpozimin e direktivave të përafritit të ri, global dhe të vjetër. Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kujdesit shëndetësor për popullatën nëpërmjet reformimit të thellë të sistemit shëndetësor aktual bazuar në modelet dhe përvojat me të suksesshme bashkëkohore. Zbatimi për produktet që e kanë origjinën në Komunitet ose Shqipëri të renditura në Kapitujt 25 deri 97 të Nomenklaturës së Kombëtarë, me përjashtim të produkteve të renditura në Shtojcën I. § I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT 1994). Shfuqizimi i të gjitha kufizimeve sasiore për eksportet dhe masat me efekt të njëjtë me to. Rritja e aksesit ndaj shërbimeve shëndetësore efektive dhe kryesisht në ofrimi i një mbulëse të qëndrueshme me barna. Forcimi i kapaciteteve kontrolluese dhe monitoruese të prodhimit, ruajtjes dhe tregimit të barnave nëpërmjet fuqizimit të inspektimit dhe strukturave që lidhen me informacionin e barnave, farmakovigjilencen.

## 2 Situata aktuale

### 2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Ligjet dhe aktet nënligjore, aktet komunitare që transpozohen si dhe shkallën e përputhshmërisë së tyre.

1. Ligji Nr. 9644, datë 20.11.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” të ndryshuar”. Objekti: Përcaktimi i parimeve dhe procedurave për vendosjen e çmimeve. Subjekti: Komisioni i Çmimit të Barnave
2. 31989L0105, Direktiva 89/105/EEC e Këshillit të 21 dhjetorit 1988 në lidhje me transparencën e masave rregulluese të çmimeve të produkteve mjekësore për përdorim njerëzor dhe përfshirjen e tyre në kufijtë e sistemeve kombëtare të sigurimeve shëndetësore. Fletore zyrtare L 040 , 11/02/1989 P. 0008 - 0011 Objekti: Rregullimi i masave për vendosjen e çmimeve për të siguruar transparencën në vendosjen e çmimeve. Subjekti: Autoritetet Kombëtare
3. Shkalla e Përafritit / E pjesëshme

❖ Ligjet dhe aktet e tjera që nuk transpozohen akte komunitare.  
Fusha e barnave rregullohet nga legjislacioni i mëposhtëm:

Ligji nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" pjesërisht i përafëruar me Direktivën 2001/83/EC dhe "Kodin Komunitar në lidhje me produktet mjekësore me përdorim njerëzor".

Ligji Nr. 9644, datë 20.11.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” të ndryshuar”.

VKM nr. 52, datë 27.10.2005 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Çmimeve të Barnave" plotësisht e përafuar me Direktivën 89/105/EC, datë 21.12. 1988 "Mbi transparencën e masave që rregullojnë çmimet e barnave për përdorim njerëzor dhe përfshirja e tyre në sistemin kombëtar të sigurimeve shëndetësore” ;

VKM nr. 325, datë 14.6.1993 “Për regjimin e eksport-importit dhe prodhimin e barnave”;

Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Financave nr. 180, datë 13.8.1993 “Për bashkëpunim në regjimin e import – eksportit të barnave”;

Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë, nr.104, datë 5.3.2004 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 180, datë 13.8.1993 “Për bashkëpunimin në regjimin e import-eksportit të barnave dhe zhdoganimin e tyre”;

Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë nr. 214, datë. 22.4.2004

Rregullore nr. prot. 399, datë 20.1.1998 “Për fabrikimin e barnave”;

Rregullore e shërbimit farmaceutik nr. prot. 296, datë 26.1.1998.

## **2.2 Kuadri institucional ekzistues**

- a) Ministria e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e farmaceutikës.
- b) Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave është institucion i specializuar për analizën, regjistrimin, kontrollin e barnave dhe inspektimin farmaceutik. Kontrolli i saj shtrihet mbi veprimtaritë, mjediset, pajisjet e fabrikimit; tregtimin me shumicë e pakicë, kushtet e ruajtjes së barnave dhe barnat e importuara. QKKB përbëhet nga Sektori i Regjistrimit, Sektori i Inspektimit, Sektori i Analizave, Sektori i Informacionit, Sektori i Farmakovigjilencës dhe Sektori i Administratës.

## **3 Adresimi i prioriteteve**

### **3.1 Prioritetet afatshkurtra (2007 -2008)**

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si me poshtë:

- *Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;*
- *Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafritit të ri*

#### **3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra (2007 – 2008)**

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Amendimi i Ligjit Nr 9323, date 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” i cili do të përafrohet pjesërisht me:

- Direktiva e Këshillit (85/432/EEC) e datës 16 Shtator 1985 në lidhje me bashkërendimin e dispozitave të ligjit, rregulloreve ose masave administrative mbi aktivitetet të caktuara në fushën e farmacisë.
- Direktiva e Komisionit 2003/94/EC e datës 8 Tetor 2003 që cakton parimet dhe udhëzimet për praktikën e mirë për prodhimin në lidhje me produktet mjekësore për përdorim njerëzor dhe produktet mjekësore kërkimore për përdorim njerëzor.
- Direktiva 2001/83/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 6 Nëntor 2001 mbi Kodin Komunitar në lidhje me produktet mjekësore për përdorim njerëzor.
- Rregullorja Nr. 41 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 Dhjetor 1999 “Mbi produktet mjekësore jetime”

### 3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra (2007 -2008)

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Ngritja e kapaciteteve për praktiken e mire te fabrikimit;
- Rritja e kapaciteteve administrative ne fushën e praktikës se mire klinike.

**Tabela 1**

**Forcimi i kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Shëndetësisë**

INVESTIME	NJËSIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	VITET			
			2007	2008	2009	2010
1.Shtim personash	persona	5	2	4	X	X
4.Trajnime (mijë lekë)	(mijë lekë)	X	1250	7500	5625	7500

# **DIREKTIVAT E PËRAFRIMIT TË VJETËR (OLD APPROACH DIRECTIVES) PRODUKTET KOZMETIKE**

## **1 Objektivi politik**

Sigurimi në mënyrë graduale i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet dhe rregullat teknike mbi sigurinë e produkteve shqiptare dhe procedurat evropiane të vlerësimit të konformitetit, është një nga detyrimet kryesore të vendit tone, i cili përcaktohet në nenin 75 të MSA-së. Rritjen e sigurimit të kapaciteteve administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe të arrijë një progres të dukshëm në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri, global dhe të vjetër. Rregullimi i prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve kozmetike cilësore e të sigurta në përputhje me standardet e përcaktuara në direktivat e BE.

## **2 Situata aktuale**

### **2.1 Kuadri ligjor ekzistues**

Fusha e produkteve kozmetike është një fushë e re e cila nuk ka ende një kuadër ligjor ekzistues. Por parashikimet ligjore të bëra nga Ministria e Shëndetësisë kanë si qëllim plotësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e këtij të fundit me legjislacionin evropian të identifikuar.

### **2.2 Kuadri institucional ekzistues**

- a) Ministria e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e produkteve kozmetike si dhe për përafrimin e këtyre akteve me legjislacionin evropian.

## **3 Adresimi i prioriteteve**

### **3.2 Prioritetet afatmesme (2009-2010)**

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhtë:

- *Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.*
- *Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër*

#### **3.2.1 Inicativat ligjore afatmesme (2009-2010)**

Projekt-ligji “Për produktet kozmetike” i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 76/768/EEC mbi përafrimi e ligjeve në lidhje me produktet kozmetike, Direktivën 80/1335/EEC lidhur me përafrimin e ligjeve për metodat e analizimit të nevojshëm për kontrollin e përbërjes së produkteve kozmetike, Direktivën e dytë 82/434/EEC lidhur me përafrimin e ligjeve për metodat e analizimit të nevojshëm për kontrollin e përbërjes së produkteve kozmetike, Direktiva e gjashtë, 83/514/EEC lidhur me përafrimin e ligjeve për metodat e analizimit të nevojshëm për kontrollin e përbërjes së produkteve kozmetike, Direktivën 85/490/EEC, Direktivën 95/32/EC dhe Direktivën 96/45/EC.

Projekt-VKM për miratimi i listës së lendeve të ndaluara për prodhimin e produkteve kozmetike, duke përafuar direktivat e mësipërme.

### 3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme (2009-2010)

- Ngritja e strukturave për kontrollin e produkteve kozmetike;
- Trajnimi i specialisteve mbi zbatimin e legjislacionit për produkte kozmetike.

**Tabela 1**

**Forcimi i kapaciteteve institucionale të institucionit (ky i fundit do të përcaktohet në ligjin përkatës)**

INVESTIME	NJËSIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	VITET			
			2007	2008	2009	2010
1.Shtim personash	persona	3	X	X	X	X
4.Trajnime (mijë lekë)	(mijë lekë)	0	X	X	X	430.5

# **NJOHJA RECIPROKE E KUALIFIKIMEVE PER PROFESIONET E LIRA**

## **1 Objektivi Politik**

Në kuadër të zbatimit të Nenit 54 të Marrëveshjes se Stabilizim-Asociimit Qeveria Shqiptare angazhohet të marrë hapa të nevojshëm për njohjen reciproke të kualifikimeve, për të lehtësuar aktivitetet profesionale të shtetasve shqiptare dhe shtetasve komunitarë në Shqipëri si dhe Përafrimin e Legjislacionit vendas me acquis mbi ushtrimin e disa profesioneve të lira.

## **2 Situata aktuale**

### **2.1 Kuadri ligjor ekzistues**

Baza ligjore që përcakton veprimtarinë e mjekut, farmacistit, mamive infermierëve dhe dentistëve që licensohen së bashku me kriteret e licensimit është:

- VKM 238/2003 “Për licensimin e veprimtarisë private në fushën e shëndetësisë”
- Ligjin 8615/2000 “Për Urdhërin e Mjekut në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhërin e Farmacistëve në RSH"
- Ligj nr. 9718, datë 19.04.2007 "Për krijimin e Urdhrit infermier-mami në Republikën e Shqipërisë".
- Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë 108/2002 “Për dhënien e licensës për ushtrim të profesionit në fushën e shëndetësisë në profesion të lirë privat”
- Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë 309/2003 “Për transferimin e aktivitetit privat në fushën e shëndetësisë”
- Urdhëri 346/2004 “Mbi kriteret e licensimit të subjekteve private në profesonin e mjekut, farmacistit, stomatologut”, si dhe një sërë udhëzimesh e rregulloresh.

Baza ligjore që përcakton veprimtarinë e arkitektit që licensohen së bashku me kriteret e licensimit është:

- VKM 613/1993, “Për ushtrimin e veprimtarive në ndërtim dhe projektim të shoqërive”
- Rregullore “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale për punët dhe shërbimet publike”

Baza ligjore që përcakton veprimtarinë e avokatit dhe noterit që licensohen së bashku me kriteret e licensimit është :

- Kushtetuta e RSH-së. Neni 49 i Kushtetutës sanksionon të drejtën e fitimit të mjeteve të jetesës me punë të ligjshme, të zgjedhur ose pranuar vetë. Çdo person është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.

### **2.2 Kuadri institucional ekzistues**

- a) Ministria e Shëndetësisë licenson subjektet private, vendas apo të huaj, që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e shëndetësisë. Organi përgjegjës për pranimin e kërkesave të subjekteve dhe për përgatitjen e materialeve për Komisionin e Posaçëm të dhënies së Licensave, është Sektori i Licensimit, në Drejtorinë Juridike, të Marrëdhënieve me Jashtë dhe të Licensimeve. Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licensave është organ vendimmarrës. Ky komision mblidhet një herë në muaj dhe është i përbërë nga Kryetar i Komisionit ZV. Ministri i Shëndetësisë dhe ka si anëtarë Drejtorët e të gjitha Drejtorive

- të Ministrisë së Shëndetësisë, një jurist, një anëtar të Urdhërit të Mjekut, Drejtori i ISKSH -së, anëtar nga Ministria e Mjedisit, Drejtori i QKKB -së.
- b) Urdhëri i Mjekëve të Shqipërisë është ent publik, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesioneve mjekësore dhe rregullon marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e mjekut ose të stomatologut në Republikën e Shqipërisë pa qenë anëtar i Urdhërit të Mjekëve. Misioni i Urdhërit të Mjekëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve mjekësore dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i mjekësisë. Urdhëri i Mjekëve jep dhe heq të drejtën individuale për ushtrimin e profesionit të mjekut dhe stomatologut.
- c) Urdhëri i Farmacistëve është ent publik, i cili përbëhet nga individët, që ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqëson interesat e tyre profesionale në nivel partneriteti institucional. Asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhërit të Farmacistëve. Për këtë qëllim jep dhe heq të drejtën vetjake për ushtrimin e këtij profesioni. Urdhëri i Farmacistëve ka për mision ruajtjen dhe garantimin e nivelit të lartë të formimit dhe edukimit shkencor e profesional të farmacistëve, ushtrimin e profesionit, sipas kërkesave shkencore, normave të etikës mjekësore e të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare dhe mbrojtjen e pacientëve e të konsumatorëve nga kequshtrimet profesionale dhe shkeljet e normave të detyrueshme.

### 3 Adresimi i prioriteteve

#### 3.1 Prioritetet afatshkurtra (2007 - 2008)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

- *Lehtësimi i aktiviteteve profesionale të shtetasve shqiptare dhe atyre të Komunitetit në Shqipëri dhe vendet respektive të Komunitetit.*

##### 3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra 2007-2008

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Projekt ligji “Për infermieristikën”, i cili ka për qëllim jo vetëm përmirësimin e shërbimit infermieror në të gjithë strukturat shëndetësore, por dhe të vënies së rregullave për njohjen e kualifikimit profesional të infermierëve sipas normave komunitare. Do të sjellë harmonizim të pjesshëm me Direktivën 2005/36 EC.
- Ndryshime në ligjin nr.9109,dt.17.07.2003 “Për Profesionin e Avokatit në RSH” si dhe Projektakti“ për heqjen e pengesave në qarkullimin e lirë të personave dhe të shërbimeve të shtetasve të Komunitetit Evropian në Shqipëri dhe anasjelltas”, të cilët do sjellin një harmonizim të pjesshëm me Direktivën 77/249/EEC dhe Direktivën 98/5/EC.
- Hartimi i Projektligjit "Për profesionet e lira në fushën e shëndetësisë" për të sjellë një harmonizim të plotë me Direktivën 2005/36 EC.

##### 3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra (2007-2008)

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Njohja me legjisllacionin komunitar në fushën e profesioneve të lira në fushën e shëndetësisë;
- Ngritja e Urdhërit të infermierit.

#### 3.2. Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

- *Përafrimi i legjislacionit vendas me acquis mbi ushtrimin e disa profesioneve të lira.*

### **3.2.1      *Iniciativat ligjore afatmesme***

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore

- Ndryshim legjislacioni për lejet profesionale në fushat publike, në përputhje të plotë me Direktivën 2005/36 EC.
- Projektakti “ për heqjen e pengesave në qarkullimin e lirë të personave dhe të shërbimeve të shtetasve të Komunitetit European në Shqipëri dhe anasjelltas” si dhe Projektakti nënligjor mbi njohjen reciproke të kualifikimeve të profesioneve të lira si avokat, noter, eksper ligjor, në përputhje të plotë me Direktivën /249/EEC dhe direktivën 98/5/EC.

## CILËSIA E UJIT TË PIJSHËM

### 1 Objektivi politik

Shqipëria, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të ndërmarra në dokumentin e Partneritetit, synon të zhvillojë dhe zbatojë strategjinë kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Sanitetit si dhe Strategjinë Rurale të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve. Do të zhvillohet dhe të nisat zbatimi i një strategjie për harmonizimin progresiv me *acquis* në fushën e furnizimit me ujë dhe higjienës, që do të përafrojë standardet e cilësisë së ujërave në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

### 2 Situata aktuale

#### 2.1 Kuadri ligjor ekzistues

VKM Nr 145, datë 26.02.1998 "Për miratimin e rregullores higjieniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm"
OJ L 229, 30.8.1980, p. 11), Direktiva 80/778 EEC e Gushtit 1993 "Mbi cilësinë e ujit me qëllim konsumimi nga njerëzit"
<i>Objekti:</i> Mbrojtja e shëndetit publik nga efektet e ndotjeve të ujit për konsum njerëzor <i>Subjekti:</i> Ministria e Shëndetësisë, Ministria e punëve publike dhe rregullimit të Territorit dhe Ministria e Brendshme
3. Shkalla e Përafrimit: E pjesshme

Ligjet dhe aktet e tjera që nuk transpozojnë akte komunitare:

- Ligji Nr. 7643, datë 2.12.1992 "Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror";
- Ligji Nr 9635, datë 6.11.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7643, datë 2.12.1992 "Për inspektoriatin sanitar shtetëror"
- VKM Nr 609, datë 17.11.2000 "Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale";
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit dhe Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal, Nr 203, datë 06.06.1995 "Për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm të puseve";
- Rregullore Nr. 4, datë 1.12.1987 "Për kërkesat higjieno-sanitare të pishinave";
- Rregullore Nr. 3, datë 4.5.1989 "Për kushtet higjieno sanitare të plazheve dhe të vendeve të larjes në lumë".
- Udhëzim i MSH, Nr 203, datë 06.06.1995 "Për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm të puseve"

#### 2.2 Kuadri institucional ekzistues

Institucionet mbështetëse të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve Publike, dhe të Ministrisë së Brendshme (ish Sekretariati Shtetëror i Pushtetit Lokal) për arritjen e detyrimit të më sipërm lidhur me sigurinë e ujit të pijshëm janë: Instituti i Shëndetit Publik, Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe nga njëra ane dhe autoritetet lokale (bashki dhe komuna), ndërmarjet e ujësjellësit nga ana tjetër. Inspektoriatin Sanitar Shtetëror monitoron, kontrollon zbatimin e rregullave higjieno-sanitare për projektimin, ndërtimin, rikonstruksionin dhe shfrytëzimin e veprave të furnizimit me ujë të pijshëm, të përcaktuara në rregulloren higjieno-sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm në bazë të VKM –së Nr. 145, datë 26.02.1998. Autoritetet lokale kanë për detyrë që të sigurojnë sidomos në rastet e përdorimit të puseve kolektive marrjen

e masave konstruktive dhe higjieniko shëndetësore, sipas detyrave të lëna nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror gjatë inspektimit.

### 3 Adresimi i prioriteteve

#### 3.1 Prioritetet afatshkurtra (2007 -2008)

- Të merren masa për cilësinë e ujit të plazheve
- Të merren masa për cilësinë e ujit të pijshëm

##### 3.1.1 Inicativat ligjore afatshkurtra (2007 – 2008)

- Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë për amendimin e Rregullores Nr 4, datë 10.05.1989 "Për kërkesat higjieno-sanitare të pishinave" që do të sjellë një harmonizim të pjesshëm me Direktivën EC 76/160 (për pishinat);
- Amendim i VKM -së Nr 145, datë 26.02.1998 "Për miratimin e rregullores higjieno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm" harmonizim të pjesshëm me Direktivën EC 80/778, dhe Direktivën EC 98/83.

##### 3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra (2007 – 2008)

- Organizimi i trajnimeve në fushën e veprimtarisë së inspektoriatit sanitar shtetëror.

#### 3.2 Prioritetet afatmesme (2009-2010)

##### 3.2.1 Inicativat ligjore afatmesme (2009-2010)

- Rishikimi i Rregullores higjieno-sanitare të plazheve dhe të vendeve të larjes në lumë, liqen (Nr. 3 Datë 04.05.1989) e cila synon të transpozojë plotësisht Direktivën 75/440EEC për ujërat sipërfaqësorë dhe Direktivën 76/160 për ujërat larës.
- Amendimi i VKM Nr 609, datë 17.11.2000 "Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale" e cila synon të transpozojë pjesërisht Direktivën CEE 80/777 mbi përdorimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale.

##### 3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme (2009-2010)

- Plotësimi i metodikave të punës së inspektoriatit sanitar shtetëror sipas përshtatjes me vendet komunitare.

**Tabela 1**  
**Forcimi i kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Shëndetësisë**

INVESTIME	NJËSIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	VITET			
			2007	2008	2009	2010
1.Shtim personash	persona	300	X	30	X	X
4.Trajnime (mijë lekë)	(mijë lekë)	X	X	1200	X	X

# **SIGURIA BERTHAMORE DHE MBROJTJA NGA RREZATIMET**

## **1 Objektivi politik**

Një nga angazhimet e Shqipërisë që rrjedhin në kuadër të MSA-së, konkretisht nenit 70/3 të saj, është edhe përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë bërthamore dhe rrezatimeve.

## **2 Situata aktuale**

### **2.1 Kuadri ligjor ekzistues**

Aktualisht, për shkak të mungesës së prodhimeve radioaktive në vend dhe përdorimit të kufizuar të burimeve radioaktive për qëllime shëndetësore dhe industriale, mbrojtja nga radioaktiviteti nuk ka qenë prioritarë në Shqipëri dhe legjislacioni në këtë fushë ka qenë nën këndvështrimin e Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimet. Janë ratifikuar disa konventa ndërkombëtare, por nuk është ratifikuar Konventa për Sigurinë Bërthamore dhe protokolle shtesë me IEAE. Legjislacioni aktual në këtë fushë përfshin:

- Ligjin Nr.8095, datë 09.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, mbështetur në Konventën e Mbrojtjes nga Rrezatimet. Ai rregullon menaxhimin e mbetjeve radioaktive në Shqipëri.
- Ligjin Nr. 8934, datë 05.09.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- VKM Nr.103 datë 31.03.2002 “Mbi monitorimin e mjedisit në RSH”.
- Ligji Nr. 8028, datë 9/11/1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet”
- Urdhër Nr.78, datë 27/03/2002 “Mbi liçensimin e kabineteve të radiologjisë dhe qendrave që përdorin burime të rrezatimit jonizues” Kodi i drejtimit për sigurimin dhe sigurinë e burimeve radioaktive Nr.1388, datë 14/04/2004
- Rregullore për transportin e sigurt të materialeve radioaktive Nr.3918/1, datë 3/11/2004
- Rregullore për trajtimin e mbetjeve radioaktive Nr.3918/2, datë 3/11/2004.
- Rregullorja mbi liçencimin dhe inspektimin e aktiviteteve me burime të rrezatimit jonizues Nr 3918/3, datë 3/11/2004
- Rregullorja mbi përdorimin e sigurt të materialeve radioaktive Nr. 3918/5, datë 3.11.2004
- Rregullore e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi Nr. 1470, datë 16/05/2005
- Urdhër Nr. 37 /1, datë 02/02/2006 “Mbi certifikatën e cilësisë që duhet të paraqesin subjektet, të cilët do të importojnë pajisje gjeneratorë me rreze x “
- Kodi i praktikës në radioterapi Nr.804/1, datë 15/03/2005
- Kodi i praktikës për mbrojtjen nga rrezatimi në rentgendiagnostike Nr.804/2, datë 15/03/2005
- Kodi i praktikës në mjekësinë bërthamore Nr. 1127, datë 13/04/2005
- Kategorizimi i burimeve radioaktive në RSH Nr. 4756/2, datë 21/12/2006
- Udhëzuesi mbi import-eksportet e materialeve radioaktive Nr 4756/1, datë 21/12/2006
- Urdhër Nr.37 datë 02/02/2006 “Mbi procedurat e liçensimit të qendrave spitalore në të gjithë prefekturat

### **2.2 Kuadri institucional ekzistues**

Institucionet përgjegjëse në lidhje me sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimet janë MSH, Komisioni Ndërmintor për Mbrojtjen nga Rrezatimet (KNMRR), Akademia e Shkencave - Instituti i Fizikës Bërthamore dhe MMPAU.

## **3 Adresimi i prioriteteve**

### **3.1 Prioritetet afatshkurtra (2007 – 2008)**

- *Të forcohen kapacitetet administrative dhe bashkërendimi në nivel kombëtar dhe vendor.*
- *Të miratohet një strategji për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit për mjedisin me acquis të BE-së dhe të zbatohet siç duhet legjislacioni ekzistues, veçanërisht për sa i përket ekzekutimit.*

#### **3.1.1 Inicativat ligjore afatshkurtra (2007-2008)**

- Projektligj "Për disa ndryshime të ligjit për Mbrojtjen nga rrezatimet Nr. 8025, datë 9/11/1995", i cili do të përafrojë plotësisht Direktivën e Këshillit të Evropës 96/29 CE Euratom datë 13 Maj 1996 lidhur me standardet bazë të sigurisë shëndetësore për mbrojtjen e punonjësve dhe publikut të gjerë ndaj dëmeve që shkaktohen prej rrezatimit jonizues
- Amendim i VKM-së mbi import-eksportet e materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Kodin e Drejtimit IAEA IAEA/code/2004 dhe Udhëzuesin e import-eksporteve të IAEA.
- Ndryshimi i Planit të Emergjencave Radiologjike dhe përshtatje e tij në lidhje me strukturat e reja. Ky akt do të transpozojë pjesërisht Direktiva e Këshillit të Evropës 89/618 Euroatom 27.11.1989 për informimin e publikut dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e shëndetit në rast emergjente radiologjike.
- Hartimi i rregulloreve për mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht, për mbrojtjen e publikut dhe për mbrojtjen në ekspozimet mjekësore, të cilat do të mbështeten në Direktivën e Këshillit të Evropës 96/29 CE Euratom datë 13 Maj 1996, si dhe Direktivën e Këshillit të Evropës 97/43 Euroatom 30.06.1997.
- Rishikim i Rregullores mbi Liçencimin dhe Inspektimin mbështetur në Basic Safety Standard, Nr 115 (rregullore e ANEA)
- Rishikim i rregullores mbi përdomin e sigurt të materialeve radioaktive mbështetur në Basic Safety Standard, Nr 115 (rregullore e ANEA)
- Hartimi i Rregullores për ekspozimet mjekësore e cila synon të arrijë përputhshmëri të plotë me Direktivën e Këshillit të Evropës 96/29 CE Euratom datë 13 Maj 1996, Direktiva e Këshillit të Evropës 89/618 Euroatom 27.11.1989.
- Hartimi i Rregullores për ekspozimet e publikut e cila synon të arrijë përputhshmëri të plotë me Direktivën e Këshillit të Evropës 96/29 CE Euratom datë 13 maj 1996 lidhur me standardet bazë të sigurisë për mbrojtjen e punonjësve shëndetësore dhe publikut të gjerë ndaj dëmeve që shkaktohen prej rrezatimit jonizues.

#### **3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra (2007-2008)**

- Aplikimi i procedurave të reja për importin e materialeve radioaktive
- Njohja me legjislacionin komunitar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet
- Riorganizimi i strukturave të kontrollit për mbrojtjen nga rrezatimet
- Përcaktimi i strukturës për zbatimin e planit të Emergjencave radiologjike
- Riorganizim i komisionit të mbrojtjes nga rrezatimi

### **3.2 Prioritetet afatmesme (2009-2010)**

- *Të vazhdohet me zbatimin e angazhimeve rajonale dhe ndërkombëtare për mjedisin*

#### **3.2.1 Inicativat ligjore afatmesme (2009-2010)**

- Rishikim i gjithë rregulloreve si transport, mbetje, liçensim dhe punë të sigurt, etj mbështetur në Mbrojtje dhe Siguri në transport-Safety and Security Transport (rregullore e ANEA).

### 3.3 Prioritetet afatgjata (2011-2012)

#### 3.3.1 Iniciativat ligjore afatgjata (2011-2012)

- Projektligj "Për transportin e mbetjeve radioaktive" i cili do të transpozojë pjesërisht 92/3 EURATOM Direktiva e Këshillit e 3 Shkurtit 1992, 94/C224/02 për Direktivën e këshillit 92/3/EURATOM, 93/552/EURATOM, 93/1493/EURATOM, 93/C335/02.
- Projektakt "Për ushqimet e kontaminuara" i cili do të transpozojë pjesërisht rregulloret e Këshillit 737/90 EEC, 616/2000 EEC, 3954/87 EEC, dhe Rregulloret 1609/2000 EEC, 1661/99 EEC, 1621/2001/EEC, 1608/2002/EEC.

#### 3.3.3 Aktivitetet zbatuese afatgjata (2011-2012)

- Forcimi i kapaciteteve të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet

**Tabela 1**

**Forcimi i kapaciteteve institucionale të strukturave të parandalimit të ndotjes (mbrojtja nga rrezatimet)**

INVESTIME	NJËSIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	VITET			
			2007	2008	2009	2010
1.Shtim personash	persona	1	1	4	2	1
4.Trajnime (mijë lekë)	(mijë lekë)			4000	4000	

## SHËNDETI PUBLIK

### 1 Objektivi politik

Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kujdesit shëndetësor për popullatën është objektiv madhor i qeverisë shqiptare. Për arritjen e këtij objekti, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme do të fokusohen në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit publik duke iu përshtatur ndryshimeve ekonomike, shoqërore dhe epidemiologjike të vendit; përmirësimin të politikave stimuluese për shërbimin shëndetësor privat, si dhe forcimin e ligjshmërisë, standardeve, strukturave kontrolluese e monitoruese ndaj tij për të mbrojtur shëndetin e popullatës nga abuzimet e praktikave të dëmshme; rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit lidhur me mbikëqyrjen e situatave të sëmundjeve ngjitëse dhe inspektoratit sanitar duke i adoptuar ato sipas standardeve të BE-së. Forcimi i kapaciteteve teknike të Ministrisë së Shëndetësisë për hartimin e politikave, strategjive apo planeve kombëtare të zhvillimit të sistemit shëndetësor duke iu shmangur gradualisht rolin tradicional të menaxhimit direkt të shërbimeve shëndetësore është një tjetër aspekt i rëndësishëm i cili do të ndiqet nga zgjerimi i mbikëqyrjes epidemiologjike duke përfshirë survejancën sindromike për sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përfshirjen e institucioneve të tjera, etj, përforcimin e survejancës të gjeneratës së dytë për HIV/AIDS.

### 2 Situata Aktuale

#### 2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Ligjet dhe aktet nënligjore, aktet komunitare që transpozohen si dhe shkallën e përputhshmërisë së tyre.

1. Ligji Nr 9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit"

Objekti(i)Përcaktimi i masave për kufizimin e përdorimit të produkteve të duhanit dhe mbrojtjen e publikut nga dëmet dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre; (ii)Përcaktimi i masave, që krijojnë premisa për ndërgjegjësimin e publikut për dëmet e duhanit dhe garantimin e një informimi efektiv dhe të vazhdueshëm të përdoruesve të produkteve të duhanit për këto dëme. (ii) Përcaktimi i masave për të parandaluar fillimin, për të nxitur dhe mbështetur ndërprerjen e përdorimit dhe për të ulur konsumin e prodhimeve të duhanit.

Subjekti: Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Bashkia, inspektorët e shëndetit publik në rrethe, etj

Direktiva 2001/37/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 qershorit 2001 mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me prodhimin, paraqitjen dhe shitjen e produkteve të duhanit. Objekti: Përafrimi i ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me nivelet maksimale të katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit tek cigaret dhe paralajmërimet në lidhje me informacionin shëndetësor.

Direktiva 2003/33/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 majit 2003 mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me reklamën dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit. Objektivi i kësaj Direktive është përafrimi i ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me reklamën e produkteve të duhanit dhe promovimin e tyre: (i)në shtyp dhe publikimet e tjera të shtypura; (b) në transmetimin me radio; (c) në shërbimet e shoqërisë së informacionit; dhe (d) nëpërmjet sponsorizimit në lidhje me duhanin, duke përfshirë shpërndarjen falas të

produkteve të duhanit.

Vendimi i Komisionit i 5 shtatorit 2003, mbi përdorimin e fotografive me ngjyra dhe ilustrimeve të tjera si paralajmërime për shëndetin mbi paketat e duhanit. Objekti: Tekstet, emrat, emrat e markave dhe shenja figurative apo të tjera që tregojnë që një produkt i caktuar duhani është më pak i dëmshëm se të tjerët nuk përdoren në paketimin e produkteve të duhanit.

### 3. Shkalla e Përafrimit / E pjesshme

Ligji Nr.9739, datë 21.5.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”. Objekti: Përcaktimi i parimeve dhe rregullave bazë të aktiviteteve transfuzionale. Subjekti: MSH, QKTGJ, bankat e gjakut, dhuruesit e gjakut, marrësit e gjakut

- Direktiva 2002/98/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 27 Janarit 2003, për vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë për mbledhjen, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e gjakut human dhe të komponentëve të gjakut. (Fletore zyrtare L 33/30, datë 08.02.2003) Objekti: Vendosja e standardeve të cilësisë dhe sigurisë të gjakut human dhe produkteve të tij për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve. Subjekti: Qeveritë e vendeve anëtare dhe kandidatet.
- Direktiva 2004/33/EC e 22 Marsit 2004 në zbatim të Direktivës 2002/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat teknike për gjakun dhe përbërësit e gjakut. (Fletore zyrtare L 91/25, datë 30.03.2004). Objekti: Kërkesat për disa procedura teknike në fushën e transfuzionit.
- Direktiva 2005/61/EC e 30 shtatorit 2005 në zbatim të Direktivës 2002/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat e gjurmimit dhe njoftimit të reaksioneve dhe ngjarjeve të rënda negative. (Fletore zyrtare L 256/32, datë 01.10.2005).
- Direktiva 2005/62/EC e 30 shtatorit 2005 në zbatim të Direktivës 2002/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me standardet dhe specifikimet Komunitare në lidhje me sistemin e cilësisë për qendrat e gjakut. (Fletore zyrtare L 256/41, datë 01.10.2005).

### 3. Shkalla e Përafrimit / E pjesshme

- Ligjet dhe aktet e tjera që nuk transpozojnë akte komunitare

Veprimtaria e kontrollit të sistemit shëndetësor shqiptar rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore:

- Ligji Nr 3766 i 1963 "Për kujdesin shëndetësor";
- Ligji Nr 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin spitalor në RSH";
- Ligji Nr 8167 i 1996 "Për shërbimin shëndetësor të stomatologjisë";
- Ligji Nr.9474, datë 09.02.2006, "Për ratifikimin e Konventës kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, "Për kontrollin e duhanit";
- Ligji Nr.9518, datë 18.04.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit".
- Ligji Nr. 9635, datë 06.11.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”.

- VKM Nr 113, datë 17.02.2007 "Për organizimin, funksionimin, përbërjen e anëtarëve të komitetit ndërsektorial për mbrojtjen nga produktet e duhanit"
- Ligji Nr. 776, datë 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse"
- Ligji Nr. 8689, datë 16.11.2000 "Për parandalimin e përhapjes së infeksionit të HIV/AIDS në RSH"
- Ligji Nr 8193, datë 1997 "Për transplantin e organeve"

## 2.2 Kuadri Institucional ekzistues

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e sistemit të shëndetit publik është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

- a) Ministria e Shëndetësisë (MSH) është organi qendror në Sistemin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, misioni i së cilës është realizimi i politikës shëndetësore në shkallë vendi.
- b) Instituti i Shëndetit Publik i cili është nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka për mision parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse, studimin e mjedisit dhe të efekteve të tij mbi shëndetin, prodhimin e vaksinave.
- c) Inspektorati Sanitar Shtetëror është organi më i lartë i kontrollit sanitar dhe është nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë. Inspektorati përbehet nga Kryeinspektori sanitar shtetëror dhe nga inspektorët sanitar në Institutin e Shëndetit Publik dhe në rrethe të cilët janë të specializuar. Ai kontrollon dhe mbikëqyr masat e sigurisë dhe shëndetin në punë, funksionimin e shërbimit mjekësor në punë, informon rregullisht Drejtorinë e ISHP dhe Kryeinspektorin Sanitar Shtetëror.
- d) Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut është institucion nën përgjegjësinë direkt menaxhuese të Ministrisë së Shëndetësisë. Aktiviteti i Q.K.T.GJ është mbledhja e gjakut, kryerja e analizave serologjike, analizave virologjike për të gjithë dhurimet e gjakut në Tiranë, përpunimi, ruajtja dhe shpërndarja e gjakut dhe produkteve të tij.

Për realizimin e detyrimeve dhe angazhimeve të marra, për çështjet ndërsektoriale MSH bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në lidhje me analizat e ajrit të ndotur, zhurmave ajrore dhe monitorimit të ujërave; Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me analizat ushqimore; Ministrinë e Arsimit dhe Shkencave në kuadër të Kurseve dhe trajnimeve të përbashkëta; Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Inspektoratit të Punës dhe Inspektoratit Sanitar Shtetëror;

## 3 Adresimi i prioriteteve

### 3.1 Prioritetet afatshkurtra (2007 - 2008)

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme për fushën e shëndetit publik janë:

- *Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor të shëndetit publik duke i përshtatur ato sipas standardeve të BE-së;*

- *Forcimi i kontrollit të sëmundjeve ngjitëse;*
- *Mbrojtja e shëndetit nga produktet e duhanit.*

### **3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra (2007-2008)**

Në përputhje me këto prioritete, për realizimin e tyre në periudhë afatshkurtër 2007-2008, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Shëndetësisë:

- Projekt-VKM “Për miratimin e strategjisë kombëtare për politikën e kontrollit të duhani në përputhje të plotë me Strategjinë Evropiane të Kontrollit të Duhanit”;
- Projekt-VKM "Për trajtimin financiar të anëtarëve të Komitetit Kombëtar të Transfuzionit";
- Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për përcaktimin e kërkesave bazë, organizative dhe teknike, të strukturave të këtij shërbimi”;
- Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për dokumentet për verifikimin e përshtatshmërisë së dhuruesve, informacionin e marrë dhe dhënë dhuruesve, mënyrën e dhurimit të gjakut ose të përbërësve të tij”;
- Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë "Për pagesat për ditën e dhurimit";
- Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë "Për miratimin e programit kombëtar të QKTGJ";
- Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë "Për miratimin e rregullores për procedurat praktike dhe dokumentacionin e detyrueshëm për importin dhe eksportin e gjakut";
- Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë "Për hartimin dhe zbatimin e skemës së hemovigjilencës";
- Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për planifikimin e fondeve për veprimtaritë, promovuese dhe edukative, në fushën e transfuzionit të gjakut”;
- Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë "Për përcaktimin e rregullave për vlerësimin e cilësisë dhe të sigurisë së gjakut e të produkteve të tij";
- Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë "Për miratimin e rregullores për funksionimin e sistemit të hemovigjilencës";
- Projekt-VKM "Për organizimin dhe funksionimin e QKTGJ dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore, sipas kategorizimit të tyre" në përputhje të plotë me Direktivën 2002/98/EC e 27 Janarit 2003, për vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë për mbledhjen, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e gjakut human dhe të komponentëve të gjakut. (Fletore zyrtare L 33/30, datë 08.02.2003)
- Projekt-VKM "Për kushtet dhe mënyrat e licensimit, krijimit e të funksionimit të qendrave të fraksionizimit të plazmës dhe prodhimit të derivateve të gjakut" në përputhje të plotë me Direktivën 2002/98/EC e 27 Janarit 2003, për vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë për mbledhjen, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e gjakut human dhe të komponentëve të gjakut. (Fletore zyrtare L 33/30, datë 08.02.2003)
- Projekt-VKM "Për përcaktimin strukturave që do të kryejnë inspektimin e qendrave të fraksionizimit të plazmës dhe prodhimit të derivateve të gjakut në përputhje të plotë me Direktivën 2002/98/EC e 27 Janarit 2003, për vendosjen e standardeve të cilësisë

- dhe sigurisë për mbledhjen, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e gjakut human dhe të komponentëve të gjakut. (Fletore zyrtare L 33/30, datë 08.02.2003)
- Projekt-VKM "Për standardet kombëtare për produktet, e prodhuara dhe të ofruara, nga strukturat e këtij shërbimi" në përputhje të plotë me Direktivën 2002/98/EC e 27 Janarit 2003, për vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë për mbledhjen, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e gjakut human dhe të komponentëve të gjakut. (Fletore zyrtare L 33/30, datë 08.02.2003)
  - Projekt-VKM "Për kushtet për hapjen dhe funksionimin e bankave të gjakut të kordonit umbilikal, për qëllim transplantit" në përputhje të plotë me Direktivën 2002/98/EC e 27 Janarit 2003, për vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë për mbledhjen, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e gjakut human dhe të komponentëve të gjakut. (Fletore zyrtare L 33/30, datë 08.02.2003)
  - Projekt-VKM "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Politikën e Kontrollit të Alkoolit";
  - Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë "Për përdorimin e fondeve për motivimin e dhuruesve të gjakut";
  - Projekt-Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë "Për procedurat dhe kriteret e akreditimit për strukturat e shërbimit të transfuzionit.
  - Projekt - VKM për miratimin e strategjisë kombëtare për politikën e kontrollit të alkoolit e cila do të jetë në përputhje të plotë me Konventën e OBSH për Evropën për kontrollin e politikave të alkoolit.
  - Amendimi i Ligjit "Për parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV/AIDS në RSH" në përputhje me Strategjinë Evropiane në fushën e shëndetit publik .

### **3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra (2007-2008)**

Për realizimin e këtyre prioriteteve, në periudhë afatshkurtër, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Ngritja e laboratorit për kontrollin e produkteve të duhanit;
- Trajnime me mjekët e familjes për të ndihmuar alkool pirësit me risk;
- Kryerja e një studimi mbi pirjen e alkoolit tek moshat mbi 15 vjeç;
- Përgatitja e strategjisë kombëtare për politikën e kontrollit të alkoolit;
- Kryerja e fushatave për ndërgjegjësimin e popullatës për masat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit";
- Fushata ndërgjegjësimi i popullatës për masat që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr 9518, datë 18.04.2006 "Për mbrojtjen e te mirurve nga përdorimi i alkoolit";
- Trajnime me mësuesit e shkollave 9 vjeçare për kontrollin e duhanit (për educator);
- Trajnime me studentët e Fakultetit të Mjekësisë dhe mjekë të shërbimit parësor për të ndihmuar duhanpirësit në lënien e duhanit;
- Sigurimi i një prevalencë të ulet të HIV/AIDS në popullatën e përgjithshme dhe mënjanimi i rritjes së saj në grupet vulnerabël;
- Forcimi i kapaciteteve të Qendrës Kombëtare për kontrollin e duhanit;
- Ngritja e strukturave lokale për kontrollin e duhanit;
- Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Politikën e Kontrollit të Duhanit;
- Ngritja e qendrës së kontrollit të jashtëm të cilësisë së gjakut;

- Krijimi i njësisë së hemovigjilencës në Tiranë;
- Tryeza te rrumbullakëta për sensibilizimin e aktoreve për zbatimin e Ligjit Nr 9518, date 18.04.2006 "Për mbrojtjen e te miturve nga përdorimi i alkoolit"
- Tryeza te rrumbullakëta për sensibilizimin e aktoreve zbatimi i ligjit "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".
- Kryerja e studimi mbikëqyrës epidemiologjik për sëmundjet infektive;
- Sigurimi një prevalencë të ulët të HIV/AIDS në popullatën e përgjithshme dhe mënjanimi i rritjes së saj në grupet vulnerabël;
- Mbajtja e mbulesës vaksinore 98-99% për secilin antigen të Kalendarit tonë kombëtar të Vaksinimit për fëmijët.

### 3.2.1 Prioritetet afatmesme (2009-2010)

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian, prioritetet afatmesme për fushën e shëndetit publik janë:

- *Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor të shëndetit publik duke i përshtatur ato sipas standardeve të BE-së;*
- *Forcimi i kontrollit të sëmundjeve ngjitëse;*
- *Mbrojtja e shëndetit nga produktet e duhanit.*

### 3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme (2009-2010)

- Ngritja e një sistemi modern të mbledhjes së gjakut, përpunimit dhe testimit të gjakut në Shkodër;
- Ngritja e një sistemi modern të mbledhjes së gjakut, përpunimit dhe testimit të gjakut në Vlorë;
- Ngritja e një sistemi modern të mbledhjes së gjakut, përpunimit dhe testimit të gjakut në Korçë;
- Trajnime me studentet e Fakultetit të Mjekësisë dhe mjekë të shërbimit parësor për të ndihmuar duhanpirësit në lënien e duhanit;
- Trajnime me mësuesit e shkollave 9 vjeçare për kontrollin e duhanit (për edukator);
- Ngritja e strukturave lokale për kontrollin e duhanit;

**Tabela 1**

**Forcimi i kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Shëndetësisë**

INVESTIME	NJËSIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	VITET			
			2007	2008	2009	2010
1.Shtim personash	persona	1	0	43	24	0
4.Trajnime (mijë lekë)	(mijë lekë)	1400	1400	25000	150	0

**Tabela 2**

**Ndihma e huaj në mbështetje të shëndetit publik**

ISTITUCIONI	DONATORI	PROGRAMI /AGJENCIA ZBATUESE	TITULLI I PROJEKTIT	VLERA	AFATI I FILLIMIT	AFATI I PËRFUNDIMIT
Ministria e Shëndetësisë , Institucionet në varësi	Qeveria Suedeze	Agjensia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar	Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe mirëmbajtjes në Shërbimin Shëndetësor Shqiptar	25.8 mln SEK	2005	2007
Ministria e Shëndetësisë , Instituti i Shëndetit Publik, Qendra Spitalore Universitare	Bashkimi European	INTERREG III A Itali-Shqipëri	Program për ngritjen e një qendre Observimi Epidemiologjik për vezhgimet e semundjeve të perhapura në popullatë	0.348 mln €	2005	2008
Ministria e Shëndetësisë , Instituti i Shëndetit Publik, Qendra Spitalore Universitare	Bashkimi European	INTERREG III A Itali-Shqipëri	Program për diagnostifikimin e parakohshëm të tumoreve të sferës gjenitale tek femrat.	0.548 mln €	2005	2008
Ministria e Shëndetësisë , Instituti i Shëndetit Publik, Qendra Spitalore Universitare	Bashkimi European	INTERREG III A Itali-Shqipëri	Bashkëpunim shkencor, teknik dhe menaxherial në fushën socio-shëndetësore	0.067 mln €	2005	2008
Ministria e Shëndetësisë , Instituti i Shëndetit Publik, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Institucionet spitalore	Bankës Botërore, Qeveria Japoneze		Modernizimi i Sistemit Shëndetësor Shqiptar	17 mln \$	2007	2010